

Për çfardo pyetje apo komunikim:

1 Nëse do të keni ndonjë pyetje me gojë apo pyetje me shkrim apo komunikim për të bërë në lidhje me këtë produkt sigurimi, me blerjen e tij, kushtet dhe implementimin, realizimin e tij, Qendra e NDIHMËS (gadishmërisë) me kënaqësi do t'ju shërbejë dhe do të ju informojë, apo në rast nevojë, t'ju lidhë me shërbimin kompetent:

Nr. tel: +41 22 929 52 51
Nr. fax: +41 22 929 52 55
E-mail: info@evasan.com

2 Kujdes ju lutem: në qoft se ndodh rasti i siguruar, është obligim dhe detyrim që menjëherë të thirret/lajmërohet/njoftohet përmes telefonit QENDRA ALARMUESE.

1.1. Përkufizime

1.1.1. Kush është siguruuesi?

Rreziqet e sigurimit të përfshira në kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta të këtij dokumenti sigurohen nga kompania e sigurimeve EUROSIG ("Siguruuesi"), Rr. 2 Korriku nr.4, 10000, Prishtinë, Kosovë; përveç atyre që kanë të bëjnë me ndihmën gjatë udhëtimit e që ofrohen nga shoqëria aksionare SOS Evasan s.a., me qendër në 12C, Rte de l'Etraz, 1267, Vich, Zvicër ("Evasan"). e cila ofron asistencën mjekësore dhe mbrojtje shëndetësore gjatë udhëtimit, e destinuar me qëllim për të ndihmuar njerëzit që ndodhen në vështirësi si pasojë e ndodhive të paparishkueshme dhe të papritura gjatë udhëtimit jashtë shtetit të tyre amë. Evasan-i i jep Siguruuesit mbështetje teknike në të gjitha Shtetet e Zonës së Schengen-it.

1.1.2. Who is the insurance taker?

1 Entiteti fizik apo ligjor që kërkon dhe merr policën e sigurimit në emër të vet apo të palës së tretë dhe që, rrjedhimisht, duhet obligohet të paguajnë primin e sigurimit.

2 Kur sigurimi merret për palën e tretë, pala e siguruar është i vetmi përfutues. Çfarëdo zotimi që marrësi i sigurimit mund të ketë marrë karshi palës të treta nuk kanë ndikim në palët kontraktuese, edhe nëse ato zotime kanë ndikuar në nënshkrimin e kontratës. Përfshirjet eksplicite në Kushtet e Veçanta të Sigurimit (këtu dhe në vazhdim ju referohemi "KVS") janë të rezervuara.

1.1.3. Kush është i siguruari (pala e siguruar)?

1 Personi që do të përfitojë nga shërbimet e Siguruuesit.

2 Shprehja e përgjithshme "pala e siguruar" dhe shprehje të tjera të nevojshme do të përdoren në tekstin e mëposhtëm për të dyja gjinitë pa dallim.

1.1.4. Çfarë kuptohet me shprehjen "familja"?

Dy të rritur dhe fëmijët e tyre nën moshën 18 vjeç, ashtu siç përcaktohet në dokumentin e policës.

1.1.5. Kush mund të konsiderohet i afërm?

Kushdo që ka marrëdhënie të afërt me palën e siguruar, pa qenë domosdoshmërisht anëtar familjeje.

1.1.6. Kush mund të konsiderohet palë e tretë?

Një person, që nuk është në ndonjë lidhje familjare me palën e siguruar, nuk është gruaja/burri i tij/saj apo bashkjeton me te, dhe nuk është i lidhur me te përmes punës apo funksionit si organ korporate.

1.1.7. Çfarë është pyetësi për sigurim?

1 Kërkesa që aplikanti e plotëson dhe ia dorëzon Siguruuesit, me synim për ta marrë policën e sigurimit. Kjo kërkesë nuk është e barazvlefshme me kontratën e nënshkruar (shihni pjesën 1.1.9).

2 Fakti që Siguruuesi i dërgon aplikantit një formular aplikimi për sigurim nuk përbën ofertë për t'u siguruar dhe nuk e zëvendëson policën e sigurimit.

1.1.8. Çfarë është një certifikatë sigurimi?

Dokument që Siguruuesi i lëshon aplikantit me kërkesë të tij/saj, në mënyrë që ky i fundit të mund të shkojë te organet përgjegjëse (konzullata, ambasada etj.) me qëllim të kompletimit të procedurave të nevojshme. Me anë të këtij dokumenti që lëshohet vetëm pasi të bëhet pagesa e primit të sigurimit, Siguruuesi deklaron gatishmërinë e vet për të lidhur marrëveshje me aplikantin, nëse përmbushen të gjitha elementet thelbësore të kontratës (shiqo pikën 1.1.9). Konfirmimi nuk është i barazvlefshëm me policën e sigurimit. Siguruuesi ka të drejtë që, në rast kthimi të primit të sigurimit, t'ju japë palëve të treta të dhënat përkatëse.

1.1.9. Çka është një kontratë sigurimi?

1. Kontrata e sigurimit është një deklaratë e përbashkët dhe e nënshkruar e dëshirave të aplikantit dhe të siguruuesit, e cila mbulon të gjitha elementet kryesore të marrëdhënies së tyre.

2. Pikat kryesore për tu përmbushur të policës janë si në vazhdim:

a) Shqyrtimi dhe pranimi i Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit (këtu dhe në vazhdim ju referohemi KPS) dhe Kushteve të Veçanta të Sigurimit (këtu dhe në vazhdim ju referohemi KVS), siç janë dorëzuar me formular;

b) Plotësimi dhe nënshkrimi i pyetësorit/formularit të propozimit të sigurimit, bashkë me dokumentet potencialisht të bashkangjitura;

c) Pranimi i pagesës së primit të sigurimit nga Siguruuesi; d) Pranimi i aplikacionit të aplikantit nga ana e siguruuesit dhe gatishmëria e këtij të fundit për të lidhur kontratë.

3. Një policë sigurimi për palën e tretë asnjëherë nuk mund të mbulojë apo të interpretohet se mbulon bartësin e policës dhe një palë të tretë njëkohësisht.

1.1.10. Çka është dokumenti i policës së sigurimit?

Dokumenti që vërteton dhe dëshmon ekzistencën e një police sigurimi dhe përfshin të drejtat dhe detyrimet e palëve.

1.1.11. Çka janë destinacioni dhe territori?

1 Destinacioni është vendi ku pala e siguruar synon të shkojë gjatë udhëtimit.

2 Territori përfaqëson zonën gjeografike apo politike, ashtu siç përkufizohet në kontratë dhe në kuhstet përkatëse KPS-të dhe KVS-të, ku gjenden detyrimet kontraktuese të plotfuqishme dhe brenda të cilave mund të shihet dhe destinacioni.

1.1.12. Çka konsiderohet dëm?

Ndodhia e paqëllimshme dëmtuese në bazë të cilës mund të paraqitet kërkesa për dëmshpërblim, e cila ndodh në periudhën dhe sipas kushteve që janë përcaktuar në kontratë dhe e cila i shkakton siguruuesit që të përmbush obligimet e tij për të ofruar shërbimin e tij palës së siguruar përbrenda kufizimeve ligjore dhe kontraktuese.

1.1.13. Çka konsiderohet aksident?

Çdo ndodhi e papritur, e pashmangshme dhe e paqëllimshme që i shkakton pasoja trupit të njeriut për të cilat mund të kërkohet dëmshpërblim e që ndodh si pasojë e një burimi të jashtëm dhe të dhunshëm që i shkakton dëme trupore palës së siguruar dhe që mund të identifikohet objektivisht.

1.1.14. Çka konsiderohet sëmundje e papritur?

Çfarëdo ndryshimi negativ dhe i paqëllimshëm shëndetësor që kërkon këshillim, trajtim apo përkujdesje mjekësore; që nuk është pasojë e ndonjë aksidenti dhe nuk është pasojë e ndonjë sëmundje paraprake / para-egzistuese.

1.1.15. Çka konsiderohet sëmundje paraprake?

Çdo ndryshim, sëmundje, çrregullim trupor apo mendor i pranishëm para datës së blerjes së policës të sigurimit; paraqitja, pasojat apo ndërlikimet e mëpasme të cilat kërkojnë trajtim, këshillim apo ndërhyrje mjekësore gjatë periudhës së mbulimit me sigurim në rast të simptomave apo komplikimeve të vazhdueshme. Sugjerohet që i siguruari të bëjë një kontroll të hollësisht mjekësore, me shpenzimet e veta, para se ta nënshkruajë marrëveshjen e sigurimit.

1.1.16. Çka është "Qendra e Alarmit"?

Objektet e ndihmës dhe ekipi i përbërë prej mjekësh, infermierësh dhe operatorësh që ofrohen nga EVASAN-i dhe mundësojnë shërbime 24 orë në ditë / 7 ditë në javë / gjatë gjithë vitit, palëve të siguruar.

1.1.17. Çka konsiderohet shtrirje në spital?

Pranimi në objekt spitali për një periudhë prej 24 orësh apo më gjatë për operim urgjent që nuk mund të shtyhet.

1.1.18. Çka konsiderohet qendër për trajtim emergjent?

Vendi ku dërgohet pala e siguruar pas një aksidenti, me qëllim të prgatitjes për transferim apo riatdhesim.

1.1.19. Pagesa

Pranimi i pagesës së primit për sigurim nga ana e sigruerit është pjesë thelbësore e policës, pavarësisht prej mënyrës së pagesës.

1.1.20. Additional premium for sports and leisure activities

1. Opsioni për sigurim sportiv mbulon rreziqet që ndërliken me veprimtari sportive dhe rekreative, të cilat nuk përjashtohen në KPS dhe KVS.
2. Nëse pala e siguruar synon apo ka gjasa të angazhohet në veprimtari të tilla gjatë periudhës së mbulimit me sigurim, ai duhet ta përmendë këtë në pyetësor (aplikacion). Nëse Siguruesi ia pranon dhe vendos ta marr në sigurim palën në bazë të deklaratimit në pyetësor (aplikacionin), konfirmimi i opsionit për sporte dhe pagesa shtesë e primit do të evidentohen në policë.

1.1.21. Përfitimet e pjesshme

1. Nëse pala e siguruar nuk i shfrytëzon apo i shfrytëzon vetëm pjesërisht përfitimet e ofruara nga Siguruesi, ky i fundit nuk detyrohet të japë dëmshpërblim në të holla apo shërbime alternative të çfarëdo lloji.
2. Nëse shpenzimet që bëhen si pasojë e një kërkesë për dëmshpërblim janë më të ulëta se ato të përcaktuara në dokumentin e policës, pala e siguruar nuk ka të drejtë të kërkojë pjesën e mbetur.

1.1.22. Përfaqësimi i palës së siguruar

Të drejtat dhe kërkesat e çdo entiteti fizik apo ligjor që përfiton plotësisht apo pjesërisht prej garancioneve të ofruara në policën e sigurimit siç janë përcaktuar në këto KPS dhe KVS kundër palës së tretë përgjegjëse për ndodhinë apo aksidentin do t'i kalojnë Siguruesit deri në shumën e dëmshpërblimit që paguan Siguruesi.

1.1.23. Mosbartja e borxheve palëve të treta

Asnjë kërkesë për dëmshpërblim apo borxh që rrjedh prej policës së sigurimit nuk mund të bartet. Veçanërisht, përfituesi nuk mund t'ia bartë të drejtat e veta një të afërmi, spitali, kompanie, marrësi i sigurimit, kolegu pune, institucioni, autoriteti etj

1.2. Detyrimet e palës së siguruar

a) Konfidencialiteti mjekësor

Me rastin e pranimit të këtij dokumenti, pala e siguruar i liron të gjithë mjekët dhe personelin para-mjekësor që e kanë kontrolluar ate qoftë para apo pas dëmit, nga detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin mjekësor në raport me Siguruesin. Në mënyrë që të mos dënohet me humbje të të drejtave që përfshihen në kuadër të policës, pala e siguruar duhet ta përsëritë këtë autorizim pas ndodhisë/aksidentit, si dhe ta nënshkruajë formularin ad hoc të autorizimit të cilin mund të ja dorëzojë Siguruesi

b) Deklarimi në rast incidenti/aksidenti

1 Për të përfituar prej shërbimeve të Siguruesit, duhet që menjëherë të lajmërohet Qendra e Alarmit (e hapur 24 orë në ditë / 7 ditë në javë / gjatë gjithë vitit), do të thotë, sapo të ndodhë rasti dhe para çdo konsultimi apo marrje shërbimi:

Nr. tel.: +41 22 929 52 52
Nr. i fax-it: +41 22 929 52 55

2 Lajmërimi i incidentit/aksidentit që lidhet me sigurimin e aksidenteve personale gjithashtu duhet t'i dërgohet menjëherë edhe Kompanisë së Sigurimeve Eurosig Sh.A. në: claim@eurosig-ks.com

3 Nëse pala e siguruar dëshmon që e ka pasur të pamundur ta lajmërojë Siguruesin me rastin e aksidentit për shkak se ishte në rrezik për jetë, lajmërimi i bërë në rastin e parë nga pala e siguruar, mbajtësi i policës, ndonjë i afërm, policia, ndonjë institucioni mjekësor apo kujtdo që ka qenë i përfshirë në aksident, do të merret si lajmërimi i vlefshëm prej vetë palës së siguruar.

c) Dokumentet që duhen dorëzuar në rast incidenti/aksidenti Më së largu 60 ditë pas incidentit, 30 ditë pasi janë lëshuar këto dokumente apo 30 ditë pasi janë pranuar, gjë që duhet të dëshmohet nga pala e siguruar (me anë të pullës postare apo një çertifikate të bashkangjitur), pala e siguruar duhet që me shpenzimet e veta t'ia dorëzojë Siguruesit dokumentet origjinale të renditura më poshtë. Pas këtij afati, Siguruesi nuk do të japë kurrfarë dëmshpërblimi.

1. raportin e incidentit/aksidentit dhe deklaratat e marra nga policia;
2. dosjen mjekësore të plotë, të përgatitur nga mjeku apo institucioni mjekësor ku janë bërë kontrollat për shkak të incidentit/aksidentit;
3. recetat mjekësore;
4. faturat origjinale të trajtimeve mjekësore të cilave u është nënshtruar pala e siguruar, si dhe shtrimit në spital apo blerjes së ilaçeve.

d) Informatat shtesë dhe dokumentet

1. Siguruesit i lejohet të insistojë që pala e siguruar të dorëzojë, me shpenzimet e veta, të gjitha të dhënat dhe dokumentet dëshmuuese, të cilat Siguruesi i

shih si të dobishme për ta verifikuar vërtetësinë dhe rrethanat e incidentit/aksidentit, me synim të ofrimit të shërbimit në emër të palës së siguruar.

2. Nëse kërkesa i mbërrin të siguruarit me shkrim, atëherë ky i fundit ka mundësi që me një vonesë minimale prej 7 ditësh (lajmërim ligjor), të mbledh dhe më pas t'i dorëzojë të dhënat dhe dokumentet e nevojshme; pas këtij afati, pala e siguruar humb të gjitha të drejtat që burojnë prej policës së sigurimit.

1.2.1. Sigurimi i dyfishtë

1. Personi që për fusha të njëjta, brenda afateve të njëjta, është siguruar nga më tepër se një sigures, në atë mënyrë që shumat së bashku e tejkalojnë vlerën e sigurimit, duhet ta lajmërojë për këtë Siguruesin me shkrim dhe pa humbur kohë.

2. Nëse bartësi i policës e ka fshehur qëllimisht këtë fakt nga Siguruesi apo nëse ai është siguruar dyfish me qëllim të përfitimit të paligjshëm, Siguruesi automatikisht lirohet nga çfarëdo detyrimi kontraktual në lidhje me këtë aspekt.

1.2.3. Fshehja e të dhënave

Nëse personi që dorëzon pyetësorin për sigurim, derisa është lidhur marrëveshja për policën e sigurimit ka fshehur apo ka dhënë gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm, Siguruesi ka të drejtë ta zhvleftësojë policën me shkrim brenda katër (4) javësh pasi e kupton fshehjen e të dhënave. Me këtë rast merr fund edhe detyrimi për të ofruar shërbimet e tij kur është fjala për incidente/aksidente që kanë ndodhur kur të dhënat e mbajtura fshehtë kanë bërë që ai incident/aksident të ndodhë apo kanë ndikuar në përmasat e tij. Gjithashtu, Siguruesi ka të drejtë të kërkojë riimbursim për shërbimet tashmë të ofruara.

1.2.4. Përkeqësimi i rrezikut

1. Nëse pala e siguruar shkakton një përkeqësim të dukshëm të rrezikut gjatë periudhës së sigurimit, Siguruesi nuk është më i detyruar të respektojë kontratën. Pala e siguruar e ka për detyrë ta njoftojë menjëherë Siguruesin duke thirrur Qendrën e Alarmit, pastaj duke i dërguar atij letër (e-mail).

2. Nëse përkeqësimi i rrezikut nuk është shkaktuar nga pala e siguruar, ai çon në anulim të menjëhershëm të policës vetëm nëse pala e siguruar nuk e ka njoftuar Siguruesin siç u cek në paragrafin e mësipërm. Nëse pala e siguruar e bën një njoftim të tillë, Siguruesi ka të drejtë ta zhvleftësojë policën brenda 14 ditësh pas njoftimit.

3. Përkeqësimi i rrezikut konsiderohet si i madh nëse ai ndikon në një faktor të rëndësishëm të vlerësimit të rrezikut, përmasat e të cilit janë përcaktuar me kontratë. Të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në vendimin e Siguruesit për ta pranuar policën apo për ta pranuar atë nën kushtet e përcaktuara me kontratë janë të rëndësishëm (veçanërisht gjendja shëndetësore apo proceset e hapura gjyqësore të palës së siguruar).

1.2.5. Shpenzimet që mbulojnë me sigurim

Shërbimet e ofruara në kuadër të dhe nga KPS-it dhe KVS-it janë të plotfuqishme, adekuate dhe ekonomike. Secila prej këtyre tri veçorive duhet të vërtetohet shkencërisht. Po qe se kjo nuk bëhet, Siguruesi rezervon të drejtën që në mënyrë të arsyeshme të zvogëlojë shërbimet që i ofron.

1.2.6. Përfshirje të përgjithshme

Më poshtë janë renditur situatat të cilat nuk i mbulon sigurimi dhe për të cilat Siguruesi lirohet nga obligimi për të ofruar shërbimet e veta:

- nëse pala e siguruar kryen një krim apo shkelje që çon në kërkesën për dëmshpërblim;
- pasojat shëndetësore që burojnë prej rrezatimit jonizues (bërthamor);
- lëndimet shëndetësore apo trupore që janë pasojë e prodhimit të substancave kimike, biologjike apo biokimike me apo pa dijeninë e personit; që janë pasojë e përdorimit të këtyre të fundit ose të valëve elektromagnetike si armë (pa marrë parasysh bashkshkaktarët e tjerë); të gjitha rreziqet që vijnë prej armëve BBK, energjisë bërthamore dhe rrezatimeve të tjera jonizuese.
- Të gjitha ndodhitë që janë vepër e Zotit (forcës madhore) apo pasojë e ndonjë fatkeqësie natyrore të shkaktuar nga shpërthimet vullkanike, rënia e meteoreve, valët e detit, tërmetet, etj.;
- nëse pala e siguruar angazhohet në veprimtari të rrezikshme që mund të shkaktojnë ndryshime të mëdha në rrezikun e mbuluar nga sigurimi;
- nëse pala e siguruar merr pjesë në sporte të rrezikshme (lëshim me parashutë, akrobatizëm, gara me mjete mekanike apo motorike, kërcim me ski, skijim jashtë zonave të lejuara, fluturim me aeroplanë pa motorë, udhëtim nëpër kanione, boks, ragbi dhe arte marcialle, etj.);
- lufta, qoftë e shpallur apo jo, 48 orë pasi Drejtoria Zvicerane e Punëve të Jashtme apo autoritete të tjera zyrtare të kenë pohuar fillimin e luftimeve;
- revolucionit, veprat e sabotazhit, huliganizmit apo vandalizimit; protestat, barrikadat rrugore gjatë demonstratave masive dhe, në përgjithësi, pengesat e çfarëdo lloji dhe masat e marra për ta rivënë rendin publik;
- epidemitë dhe pandemitë;
- nëse pala e siguruar përdor drogë, alkool apo substanca të tjera halucinogjene që shkaktojnë apo i kontribuojnë incidentit/aksidentit;
- vetëvrasja apo tentimi për t'u vetëvurrë;
- nëse incidenti/aksidenti ndodh në një vend që nuk e mbulon policia nga territori i mbuluar me sigurim apo nëse ndodh jashtë afatit të vlefshmërisë së policës.

1.2.7. Kufizimet e përgjithshme të mbulueshmërisë

a) Duke mos i përfshirë përfshirjet tjera, Siguruesi ka të drejtë të refuzojë të ofrojë shërbimet e veta, si dhe ta anulojë kontratën nëse e konsideron të arsyeshme atë, në rastet e mëposhtme:

- nëse pala e siguruar apo ndonjë palë e tretë nuk e njofton menjëherë Qendrën e Alarmit, ashtu siç është përcaktuar në pikën 1.2.;
- nëse Qendra e Alarmit nuk jep miratimin paraprak para se të marrë përgjegjësinë për ndihmë, trajtim, shtrirje në spital apo blerje të ilaçeve nga ana e palës së siguruar;
- nëse pala e siguruar nuk ia jep Siguruesit të dhënat e nevojshme dhe dokumentet origjinale apo nuk i dorëzon ato brenda afatit;
- çfarëdo gjendje shëndetësore paraprake, siç përcaktohet në pikën 1.1.15. Për më tepër, Siguruesi rezervon të drejtën t'i zvogëlojë përfitimet edhe në qoftë se gjendja shëndetësore e të siguruarit nuk ka ekzistuar paraprakisht, mirëpo bart rrezik të madh, si për shembull diabeti, shtypja e lartë e gjakut, hiperkolesterolemia, etj.;
- incidentet, problemet dhe ndërlikimet që ndërlikohen me shtatzani, në rast se rreziku ka qenë i ditur apo ka mundur të parashikohet para nisjes për në udhëtim;
- nëse pala e siguruar nuk e njofton Siguruesin për ekzistencën e një police tjetër të sigurimit që mbulon të njëjtat rreziqe;
- nëse pala e siguruar nuk ndërmerr masa të cilat mund të kishin shmangur përkeqësimin e rrezikut dhe kështu të kishin parandaluar incidentin/aksidentin;
- çdo refuzim bashkëpunimi në lidhje me pjesën 1.2.

b) Nëse pala e siguruar apo ndonjë person tjetër që vendos në emër të palës së siguruar refuzon të pranojë shërbimet e kontraktuara (bie fjala, oferta për riadhesim) që propozohen në rast incidenti/aksidenti, kontrata do të pezullohet. Të gjitha shpenzimet që i dalin palës së siguruar si pasojë e refuzimit të shërbimeve të Siguruesit, i bien në ngarkesë vetë palës së siguruar. Nëse pala e siguruar ndryshon mendje para se të përfundojë afati i mbulimit me sigurim, ai/ajo i bart të gjitha shpenzimet që lidhen me refuzimin e tij paraprak (p.sh., shpenzimet për shkak të zgjatjes së shtrirjes në spital.)

c) Për të mos shkëlur të drejtat kontraktuale, pala e siguruar dhe pranuesi i sigurimit nuk do të ndërhyjnë në mënyrën se si Qendra e Alarmit merret me kërkesat, pa pajtimin me shkrim nga kjo e fundit.

1.2.8. Pavarësia e shërbimeve

- 1 Evasan-i nuk bart përgjegjësinë për shërbimet e ofruara nga Siguruesi dhe e nejtja vlen edhe për Siguruesin kur ka të bëjë me shërbimet e ofruara nga Evasan-i.
- 2 Siguruesi dhe Evasan-i janë entitete të veçanta, nuk marrin përgjegjësi të përbashkëta dhe sigurojnë vetëm rreziqet e mbuluara apo ofrojnë ndihmë, veçmas nga njëri-tjetri.

1.2.9. Ligjet e zbatueshme dhe vendi i juridiksionit

1. Palët janë pajtuar që ligjet e aplikueshme të Kosovës rregullojnë marrëdhënien e tyre.
2. Palët janë pajtuar që nëse vjen deri te ndonjë mosmarrëveshje mes tyre rreth shpjegimit dhe realizimit të kontratës së sigurimit, pjesë e së cilës janë edhe KPS-ja dhe KVS-ja, ajo do të zgjidhet si në vijim:

- a) Para se të ndërmarrë masa juridike apo arbitrare, secila prej palëve pajtohet ta njoftojë me shkrim tjetrën, brenda 10 ditësh nga lindja e mosmarrëveshjes, me qëllimin për të gjetur një zgjidhje miqësore.
- b) Pajtimi mund të arrihet me shkrim apo sy-më-sy, me ç'rast rezultati i takimit (marrëveshje apo ndonjë formë tjetër e përfundimit të mosmarrëveshjes / mosgjetja e zgjidhjes / vazhdimi i bisedimeve) duhet të hidhet në letër dhe duhet të nënshkruhet nga palët.
- c) Në rast se palët nuk arrijnë të pajtohen, Siguruesi merr përsipër t'i dërgojë me shkrim palës së siguruar apo përfituesit një kundërshtim, pastaj edhe një vendim të brendshëm.
- d) Nëse mosmarrëveshja ndërmjet palëve vazhdon përkundër fazave të pajtimit dhe kundërshtimit, vendi i juridiksionit do të jetë:
 - i. Vendi amë i të siguarit apo përfituesit, ose zyra qendrore e Siguruesit nëse rasti paraqitet nga i siguarit apo përfituesi;
 - ii. Vendi amë i të siguarit nëse rasti paraqitet nga Siguruesi.

3 Ku ka mospërputhje ndërmjet KPS-it dhe KVS-it në gjuhë të ndryshme, palët e marrin për bazë versionin në gjuhën angleze i cili do të jetë autoritativ për të përkufizuar të drejtat dhe detyrimet e tyre.

1.2.10 Hyrja në fuqi

Këto kushte të përgjithshme për sigurim (KPS) të shëndetit në udhëtim hyjnë në fuqi më 1 dhjetor 2012.